



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

Tiranë, më 16.7.2018
Dokument parlamentar

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR SHITESËN E FINANCIMIT PËR PROJEKTIN E MODERNIZIMIT TË ASISTENCËS SOCIALE”

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, në mbledhjet e datës 16 korrik 2018, shqyrtoi projektligjin për “Ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale ””, nismë e Këshillit të Ministrave.

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë e shqyrtoi këtë projektligj në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, bazuar nenet 32 - 39 të Rregullores së Kuvendit.

Të ftuar për të marrë pjesë në mbledhjet e Komisionit dhe për të shprehur mendimin e Qeverisë, ishin zv. Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe specialistë të kësaj ministrie, si dhe zv. Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Gjatë diskutimit në komision, deputetët ngritën një sërë çështjesh në lidhje me këtë financim të shtesës së kredisë dhe shpjegime për menaxhimin e skemës së ndihmës sociale.

Të ftuarit në komision iu përgjigjen pyetjeve të deputetëve dhe u shprehën, se, projektligji ka për qëllim, nëpërmjet akordimit të një huaje në shumën 11 milionë USD, të mbështesë zbatimin e reformave të ndërmarra për përmirësimin e vendosjes së drejtësisë dhe rritjen e efikasitetit të programeve të ndihmës sociale në Shqipëri.

Gjithashtu u theksua, se ky projektligj synon të arrijë mbështetjen e zbatimit të përmirësuar të programit të ndihmës ekonomike dhe programit të aftësisë së kufizuar, si dhe mbështetjen e kapaciteteve për zbatimin e përmirësimeve të programeve të mbrojtjes sociale, të cilat do të arrihen nëpërmjet dhënies së financimit për rimbursimin e pagesave që huamarrësi ka bërë nga fondet e tij buxhetore për programin e ndihmës sociale.

Nëpërmjet projektit do të mundësohet gjithashtu asistenca teknike për forcimin e kapaciteteve zbatuese të programeve të mbrojtjes sociale.

Gjithashtu, zv. Ministrija e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, sqaroi për anëtarët e këtij komisioni, se ratifikimi i marrëveshjes, do të mundësojë:

- rishikimin e parametrave të programeve të ndihmës sociale;
- një strategji novatore dhe të mbështetur në përvojën ndërkombëtare për daljen e përfituesve të NE-së dhe integrimin e tyre drejt skemave aktive;
- përgatitjen e një politike të rishikuar për sanksionet dhe hartimin e instrumenteve për zbulimin e mashtrimeve e të gabimeve dhe mekanizmave të tjerë të inspektimit social;
- nxitjen e transparencës në komunikim e monitorim-vlerësim, si edhe në angazhimin e qytetarëve në këto procese.

Opinionin e kryetarit të këtij komisioni, z. Vasili, nëpërmjet diskutimit dhe pyetjeve për përfaqësuesit e qeverisë, pjesëmarrës në komision, ishte se:

- Objektivat e kësaj marrëveshje janë tepër të përgjithshme,
- Mungon tërësisht detajimi sipas secilit objektiv të projektligjit,
- Është e paqartë pesha që zë asistenca teknike në projektin prej 11 milionësh dollarë
- Është i paqartë shpjegimi për implementimin e kësaj shume. Kërkohej të shpjegohet se cila është pesha financiare e hartimit të dokumenteve strategjike,
- Mungon tërësisht analiza se cilat janë objektivat e përfunduar të kredisë së mëparshme prej 38 milionësh euro, të cilat imponojnë marrjen e një kredie shtesë prej 11 milionësh dollarë.

Komisioni e miratoi marrëveshjen në parin, nën për nën dhe në tërësi, me të gjitha votat e deputetëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin e saj në komisionin përgjegjës.

**KRYETARI
PETRIT VASILI**